

Keshilli i Ministrave

VENDIM
Nr.444 Date 3.9.1993

PER KRIJIMIN E KOMITETIT KOMBETAR TE DIGAVE TE MEDHA

Me propozimin e Ministrise se Ndertimit, te Strehimit dhe Rregullimit te Territorit, Keshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Prane Ministrise se Ndertimit, te Strehimit dhe RRegullimit te Territorit krijohet Komiteti Kombetar i Digave te Medha, si organ keshillues i Keshillit te Ministrave, me keto detyra:

a) Te ndjeke zbatimin e vendimeve te Keshillit te Ministrave ne fushen e zhvillimit te teknikes e te teknologjise bashkekohore ne studimet e projektimet, ne ndertimin, shfrytezimin e ne mbikqyrjen e kontrollit te vazhdueshem e te organizuar shteteror nga institucionet studimore e projektuese, ndermarrjet e ndertimit e te shfrytezimit, si dhe te ndihmoje qe te rritet pergjegjesia, disiplina teknike e siguria ne digat, te cilat jane vepra te rendesishme e komplekse.

b) Te kontrolloje zbatimin e kushteve e te normave teknike, si dhe te rregullave e te udhezimeve ne projektim, zbatim, shfrytezim e ne mbikqyrjen e kontrollin e detyrueshem te digave.

c) Te shqyrtoje e miratoje paraprakisht projektetet e digave, perpara miratimit te tyre ne organet perkatese, sipas dispozitave ne fuqi.

ç) Te shqyrtoje e miratoje dokumentacionin teknik per venien ne shfrytezim te pjesshem a te plote te digave.

d) Te pezulloje zbatimin e propjekteve, ndertimin dhe shfrytezimin e digave, kur veren shkelje te kushteve teknike te projektimit, te teknologjise se ndertimit e te shfrytezimit te digave.

dh) Te mbaje evidence te plote per digat e ndertuara e ne ndertim e siper dhe te ndjeke mbajtjen e evidencave e te dokumentacionit te plote te projekteve, zbatimin e rregullave te mbikqyrjes e te kontrollit te tyre nga administrata e ndermarrjeve gjate ndertimit e shfrytezimit dhe te realizoje nje relatim nje here ne vit prane Keshillit te Ministrave.

e) Te shqyrtoje avarite dhe demtimet kryesore qe ndodhin ne digat e medha, duke aktivizuar edhe specialiste te ndryshem qe nuk jane ne perberje te ketij komiteti, dhe te propozoje masat qe duhen marre per menjanimin e avarive.

2. Veprimtaria e Komitetit Kombetar te Digave te Medha, si rregull shtrihet ne te gjitha digat qe kane lartesi mbi 15 m, nga pjesa e thelle e bazamentit deri ne kuroren e diges, dhe ne digat me lartesi mbi 10 m, kur plotesojne nje nga keto kushte:

- gjatesia e kurrores se diges eshte mbi 500 m;

- vëllimi i rezervuarit që krijohet është mbi 1 milion m³;
- kur ka kushte të vecanta gjeologjike të bazamentit.

3. Komiteti Kombëtar i Digave të Medha mban lidhje me Komisionin Nderkombëtar të Digave të Medha dhe ndjek detyrimet që ka vendi ynë nga pjesëmarrja në këto komisione.

4. Komiteti Kombëtar i digave të Medha përbehet nga kryetari, nënkryetari, sekretari dhe 14 anëtarë, të cilët miratohen nga Kështjia e Kështjillit të Ministrave.

Komiteti Kombëtar i Digave të Medha merr vendime me shumicë votash dhe vepron sipas rregullores së brendshme që miratohet nga kryetari.

Në strukturën organizative të aparatit të Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit shtohet "Sekretari i Komitetit Kombëtar të Digave të Medha".

5. V.K.M. nr.77, datë 20.2.19986 "Për krijimin e Komitetit Shqiptar të Digave të Medha", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
ALEKSANDER MEKSI